



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**GRUPI TEMATIK ANTIKORRUPSION/KOMITETI KOORDINATOR PËR
ZBATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT**

Nr. 7806 prot.

Tiranë, më 17. 12. 2020

VENDIM

Nr. 267, datë 17. 12. 2020

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT KORRIK – SHTATOR 2020,
NË ZBATIM TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR
KORRUPSIONIT 2015-2023**

Në mbështetje të vendimit nr.516, datë 1.07.2020, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.247, datë 20.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020”, dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020 – 2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015-2023, e të Pasaportës së Indikatorëve”, si dhe urdhrin të drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, nr.38, datë 12.05.2020 “Për miratimin e Rregullores TIP, “Për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të administratës shtetërore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, Grupi Tematik Antikorrupsion/Komiteti Koordinator

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të monitorimit korrik – shtator 2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023, në mbledhjen e zhvilluar *online*, nëpërmjet platformës WebEx Cisco, datë 17.12.2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë të publikojë Raportin e Monitorimit, korrik – shtator 2020, në faqen zyrtare të saj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Ministri i Drejtësisë

Etilda Gjonaj (Saliu)





KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

RAPORT PROGRESI
MONITORIMI PËR PERIUDHËN
KORRIK-SHTATOR 2020

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE
KUNDËR KORRUPSIONIT 2015 – 2023

www.drejtesia.gov.al

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE

- *Metodologjia e hartimit të raportit të progresit*

PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJEVE KRYESORE

- *Përshkrimi i ecurisë së realizimit të aktiviteteve dhe masave*
- *Adresimi i rekomandimeve të dhëna në raportin 6-mujor të monitorimit 2020 (janar - qershor 2020)*

PROGRESI I ZBATIMIT TË SNKK

- *Aktivitetet në vijim dhe aktivitete të filluara gjatë periudhës raportuese:*
- *Masa në vijim dhe masa të filluara gjatë periudhës raportuese:*

EKZEKUTIMI I BUXHETIT

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

ANEKS

LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AZHBR	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
ILDKPKI	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KKK	Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Plani i Veprimit
SIPI/IPSIS	Sistemi i Bazës të të Dhënave Shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar
SNKK	Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit
SPAK	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SHÇBA	Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat

HYRJE

Prej vitit 2015 Shqipëria ndjek dhe zbaton Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit (SNKK). Me vendimin nr. 516, datë 1.7.2020 të Këshillit të Ministrave afati i zbatimit të SNKK u zgjat deri në vitin 2023, dhe u miratua Plani i ri i Veprimit 2020-2023, duke rikonfirmuar tre qëllimet madhore të politikës antikorrupsion: parandalim - ndëshkim - ndërgjegjësim/edukim rreth korrupsionit.

Vizioni i SNKK-së 2015-2023 është: *“Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm”*.

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023, përmban 18 objektiva specifike, të cilët janë:

Parandalim:

A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion

A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike

A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike

A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit

A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave

A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike

A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut

A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion

A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë

A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit

A.11 Adoptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore

Ndëshkim:

B.1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit

B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit

B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar

B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit.

Ndërgjegjësim:

C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit

C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit

C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Plani i Veprimit 2020-2023 parashikon masa dhe aktivitete specifike që duhen të realizohen për përmbushjen e këtyre objektivave, sipas afateve të detajuara në të. Strategjia Ndërsektoriale kundër

Korrupsionit duke qenë një strategji ndërsektoriale, është bazuar në parimin e koordinimit midis institucioneve me qëllim arritjen e objektivave që përfshihen në SKZHI, duke zbatuar një qasje sistematike dhe të integruar. Ky është një dokument veprimi me 83 masa që përfshin 22 institucione, të cilat do të punojnë së bashku për më shumë transparencë, llogaridhënie dhe efikasitet në ritmin e luftës kundër korrupsionit në vend.

Plani i Veprimit 2020-2023, është hartuar në përputhje me metodologjinë *SIFI/IPSIS*, mbështetur në tregues me bazë produkti performance me qëllim arritjen e qëllimit të politikës. Metodologjia *SIFI/IPSIS* parashikon hartimin e raporteve të monitorimit 6-mujor dhe vjetor. Raporti i Monitorimit Janar - Qershor 2020, i miratuar me vendim nr.262, datë 7.10.2020, në mbledhjen e Grupit Tematik Antikorrupsion, përmban analizimin dhe vlerësimin e zbatimit të Planit të Veprimit 2020-2023 në katër nivele: zbatimin e aktiviteteve, realizimin e masave (produkteve), arritjen e treguesve të performancës sipas vlerave vjetore të parashikuara, si dhe shkallën e realizimit të 18 objektivave përkundrejt produkteve dhe vlerave të treguesve.

Në përputhje me shkallën e zbatimit të Planit të Veprimit, sfidat dhe risqet e evidentuara për atë periudhë monitorimi, raporti 6-mujor i monitorimit dha disa rekomandime për t'u ndjekur nga institucionet zbatuese të cilat janë të rëndësishme për procesin e zbatimit në vijimësi dhe në atë vjetor.

Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit ka vazhduar të ndjekë progresin e zbatimit për periudhën e re në vijim dhe me qëllim evidentimin e ecurisë së zbatimit të Planit të Veprimit në terësi dhe gjithashtu të rekomandimeve të dhëna në raportin 6-mujor i monitorimit dhe koordinimin e hartimit të raportit vjetor të monitorimit, e ka hartuar këtë raport progresi për periudhën *1 Korrik – 30 Shtator 2020*. Raporti është mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet zbatuese të Strategjisë, në pjesën Aneks: Raporti nëntëmujor (i progresit) i monitorimit për Planin e Veprimit 2020-2023.

Raporti evidenton progresin në zbatimin e Planit të Veprimit për periudhën 3-mujore, duke marrë si bazë të dhënat e raportuara në raportin 6-mujor të monitorimit dhe evidentuar realizimin e aktiviteteve dhe të masave në vijim dhe të atyre të filluara gjatë periudhës së monitorimit.

Raporti evidenton gjithashtu ecurinë e zbatimit të **rekomandimeve** të dhëna në Raportin 6-mujor të monitorimit si më poshtë:

- realizimin e masave me synim arritjes së vlerës vjetore të treguesit të performancës,
- përmirësimin e performancës së aktivitetit të institucioneve që raportojnë aktivitete e masa në proces zbatimi,
- uljen e numrit të masave të pazbatuara,
- brendësimin e mëtejshëm të metodologjisë *SIFI/IPSIS* dhe raportimin e zbatimit të aktiviteteve dhe masave në përputhje me këtë metodologji.

Raporti 6-mujor të monitorimit përcaktonte gjithashtu **hapat** për zbatimin e rekomandimeve si më poshtë:

- të vijojë zbatimi i masave në statusin “në proces” sipas afateve të parashikuara;
- të nisë zbatimi në kohë i masave të parashikuara për periudhën në vijim;
- të tregohet kujdes për organizimin e punës dhe proceseve përkatëse për ecurinë e masave e aktiviteteve;
- të sigurohet operativiteti i burimeve dhe kapaciteteve njerëzore dhe ekspertizës së nevojshme për kryerjen e tyre;

- të garantohen burimet financiare të munguara që ndikojnë në zbatueshmërinë e masave e aktiviteteve;
- të sigurohet bashkëpunimi institucional i nevojshëm për masa e aktivitete të përbashkëta;
- të garantohet koordinimi i mjaftueshëm për të shkëmbyer në mënyrë të efektshme informacionin dhe zgjidhur problemet penguese që mund të zgjidhen nga institucionet përgjegjëse dhe bashkëpunëtores.

Metodologjia e hartimit të raportit të progresit

Drejtoria e Programeve dhe Projekteve në Fushën Antikorrupsion (DPFFA), nëpërmjet Sektorit të Programeve në Fushën Antikorrupsion kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse dhe zbatuese të Planit të Veprimit 2020-2023. Ky raport mbulon periudhën *1 Korrik deri më 30 Shtator 2020* dhe është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga të gjitha institucionet e përfshira në Planin e Veprimit 2020 - 2023 të SNKK-së.

Monitorimi i Planit të Veprimit për këtë periudhë monitorimi ka konsistuar në këto faza kryesore:

1. Raportimi i institucioneve nëpërmjet pikave të kontaktit antikorrupsion, mbi zbatimin e masave për të cilat janë përgjegjëse;
2. Analizimi i zbatimit të masave (realizimi i produkteve) duke dhënë një rezultat sasior dhe cilësor të realizimit të tyre përkundrejt kryerjes së aktiviteteve respektive të lidhura me to; dhe
3. Hartimi e konsultimi i raportit të monitorimit mbi zbatimin e PV-së në tërësinë e tij.

Secili institucion ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo qëllimi politike, objektivi specifik dhe masash të realizuar (mbi bazë aktivitete të kryera), buxhetin e parashikuar për periudhën raportuese, buxhetin e alokuar për periudhën e raportimit, problemet e hasura, hapat e mëtejshme dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, përsa i përket realizimit të masave, procesi i monitorimit është kryer për çdo qëllim politikash/qasje të strategjisë.

Pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë në mbështetje të procesit të monitorimit dërgoi dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese, shoqërisë civile, si dhe publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kryen reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit para se të miratohet nga Komiteti Koordinator në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023.

Një tryezë konsultimi me prezencë të të gjithë përfaqësuesve të institucioneve raportuese u zhvillua gjithashtu për të diskutuar mbi metodologjinë e monitorimit të kryer, vlerësimin dhe analizën e informacionit të marrë, problematikat dhe sfidat.

Ecuria e progresit në periudhën që monitorohet, klasifikohet në këto kategori:

- ***E zbatuar***: Institucionet kanë raportuar statusin “E zbatuar” për ato masa e aktivitete të cilat janë përmbushur.
- ***Pjesërisht e zbatuar/Në proces***: Institucionet kanë raportuar statusin “Në proces” për ato masa e aktivitete, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijojnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre.

- **E pazbatuar:** Të pazbatuara janë raportuar ato masa e aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese si dhe gjithashtu ato masa e aktivitete për të cilat nuk është dhënë raportim nga institucionet përgjegjëse.

PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJEVE KRYESORE

Përshkrimi i ecurisë së realizimit të aktiviteteve dhe masave

Ecuria e arritur në kuadër të përmbushjes së aktiviteteve dhe masave të parashikuara, për periudhën e monitorimit, *Korrik – Shtator 2020*, në zbatim të Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit është si më poshtë vijon:

- Transparenca e autoriteteve publike ka qenë në vëmendje dhe është monitoruar rregullisht nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; kanë vijuar monitorimet ndaj koordinatorëve të të drejtës së informimit, është vijuar me monitorimet për publikimin e programit të transparencës, të dhënave të koordinatorit dhe regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve, në njësitë e qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore me 1/4 për cdo tremujor. Kështu, aktualisht Zyra e Komisionerit ka kryer kontrollet në masën e ¾ autoritete publike nga 420 në total që janë në Republikën e Shqipërisë - (objektivi A1).
- Agjencia e Prokurimit Publik vijon aktivitetin proaktiv të saj me rekomandime të nxjerra dhe forcim i kapaciteteve të stafit teknik – (objektivi A2).
- Vijnë bashkëpunimet e ndërsjella PSH-SHCBA me qëllim trajnimin e denoncimeve kundër korrupsionit, të dhëna të raportuara në mënyrë progresive dëshmojnë për 31 referime të materialeve hetimore në ngarkim të 64 punonjës policie për veprat penale “shpërdorimi i detyrës”, “korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “kultivimi i bimëve narkotike”; ekzekutuar 13 urdhra për masë sigurimi personal shtrëngues dhe ndalues për 13 punonjës policie; vijon monitorimi/gjurmimi i të rasteve të korrupsionit por edhe të shkeljeve të tjera të denoncuar nga qytetarët sipas “Sistemi i Menaxhimit të Çështjes – SHÇBA/Portal - Ankesat” dhe forcimi i kapaciteteve të stafit të SHCBA, që gëzon atributet e OPGJ.
Të dhëna statistikore: ankesa: regjistruar dhe trajtuar 972 ankesa të publikut; Linja e gjelbër 0800 90 90: Marrë dhe shqyrtuar 6698 telefonata; Kryer 19 Inspektive të planifikuara; Kryer 48 Inspektive të paplanifikuara; për 209 punonjës të strukturave (*punonjës policie*) është sugjeruar fillimi i ecurisë disiplinore, si personat përgjegjës për shkeljet e evidentuara dhe 14 punonjës të strukturave (*punonjës policie*) janë referuar materialet procedurale pranë organit të Prokurorisë. – (objektivi A4)
- Kanë vijuar procedurat e prokurimit dhe lidhja e kontratës me operatorin që është shpallur fitues për “Shërbimin e Mirëmbajtjes së Sistemit të Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit EACIDS” - (objektivi A5).
- Me miratimin e ndryshimeve nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 101/2020, datë 23.07.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (Reforma Zgjedhore) në muajin korrik, u hapi udhë

ndërhyrjeve dhe përmirësimit, rishikimit të mëtejshëm të formateve të raportimit dhe udhëzuesve përkatës për raportimin financiar të partive politike, raportimet nga ekspertët monitorues dhe audituesit ligjorë për përdorimin e raporteve të miratuara, udhëzimeve në lidhje me raportimin financiar - (objektivi A6).

- Është kryer finalizimi (hartim dhe konsultim) i dy instrumenteve finale të politikave parandaluese kundër korrupsionit, “Metodologji e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Qeverisjen Qendrore” dhe “Plani e Integritetit të MD, 2020-2023” - (objektivi A8 e A9);
- Është kryer mbledhja e të dhënave dhe administrimi i informacioneve statistikore për veprimtarinë e institucioneve ligjzbatuese kundër korrupsionit, të dhëna të harmonizuara, duke përfshirë institucione si; Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, SPAK, Gjykatat e të tre niveleve. Gjithashtu, këto të dhëna janë mbledhur dhe përpunuar, si për Korrupsionin edhe për Krimin e Organizuar”- (objektivi A10).
- Është vijuar me procesin e forcim i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit, këtyre të fundit dhe gjyqësorit, për këtë periudhë monitorimi me 1 (një) oficer i policisë gjyqësore (femër); Është rishikuar (miratuar) formati i raportimit të të dhënave statistikore lidhur me sekuestrimet dhe ka nisur raportimi sipas formatit të ri nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm; janë krijuar seksionet e posaçme për hetimin e pastrimit të parave dhe krimin ekonomik në 7 prokurori të juridiksionit të përgjithshëm me përbërje drejtues seksioni dhe prokurorë, në 15 prokuroritë e tjera është caktuar një prokuror për ndjekjen e këtyre çështjeve; është kryer 1 trajnim i shtuar “Investigimi hetimi i aseteve kriminale dhe pastrimit parave” me 1 përfitues; 2 nga 7 aktet nënligjore për të zhvilluar luftën kundër korrupsionit në kuadër të administrimit dhe menaxhimit e aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara që rrjedhin nga korrupsioni janë miratuar, sic përmendet: udhëzimi “Për procedurat e mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave, rregullat për mënyrën e mbajtjes dhe evidentimit të shpenzimeve, limitet e kryerjes së shpenzimeve”, dhe urdhri “Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave për hartimin e listës së administratorëve të pasurisë, pranë agjencisë së administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”; është implementuar regjistri elektronik i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nën administrim nga AAPSK, dhe është azhornuar me ndryshimet që kanë ndodhur, në pritje për përdorim nga përdoruesit që do kenë akses në të - (objektivi B1).
- Të dhëna statistikore për rastë ndëshkimore nga organi ligjzbatues Polici e Shtetit dhe SHCBA: 175 referime penale për 260 subjekte, nga të cilët: 1 punonjës policie të nivelit të mesëm drejtues; 84 punonjës policie të nivelit të parë drejtues; 166 punonjës policie të nivelit zbatues; 1 punonjës administrativ; 4 efektivë të Gardës; 4 efektivë i PMNZSH-së dhe 88 shtetas. Operacione policore të kryera: Janar- Operacioni “Abuzuesit e detyrës” Durrës; 18 vendime për masën e sigurimit personal “Arrest në burg”, për: 4 punonjës policie të nivelit të parë drejtues; 6 punonjës policie të nivelit zbatues; 8 shtetas; 1 vendim për masën e sigurimit personal “Pezullim nga detyra” për; 1 punonjës administrative (strukturave të Policisë së Shtetit); Shkurt - Operacioni “Abuzuesit e detyrës 2”, Krujë: - “pezullimit nga detyra” & “ndalimit të daljes jashtë shtetit”, për 7 subjektet e këtij procedimi, të cilët kryejnë funksione të ndihmës/ndihmës/specialist për rendin në Komisarriatin e Policisë Krujë, pranë DVP Durrës; Maj- Operacioni “ShënMëri2020”Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Gjirokastrë. Ky operacion u zhvillua nga Drejtoria Vendore e Policisë Kukës, me mbështetjen e OFL-së, në koordinim me Departamentin e Policisë Kriminale dhe në bashkëpunim me SHÇBA-në, e nën Drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës; Masat e sigurisë për 19 shtetas, të dyshuar

për veprën penale “*Kultivimi i bimëve narkotike*, në bashkëpunim, si dhe u arrestuan 2 punonjës policie, A. K., dhe R. C., për veprën penale “*Shpërdorimi i detyrës*” dhe për oficerin e policisë N. K, u mor masa e sigurisë “*pezullimi nga detyra apo funksioni publik*”. Prill- Operacioni “*PANDEMIA*” nga Seksioni për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm dhe Narkotikëve në DVP Fier me strukturat e -së Fier dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Mbi bazën e informacione të marra në rrugë operative, kryerjes së veprimeve të shpejta procedurale dhe aplikimit të metodave speciale të hetimit, si rezultat i këtij operacioni i arrestuan në flagrancë 3 shtetas dhe 1 punonjës policie, efektiv i Komisarariatit të Policisë Rrugore Tiranë, të dyshuar për veprat penale “*Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve*” dhe “*Prodhim dhe mbajtja pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive*”; Operacioni “*Golemi*” i kryer në bashkëpunim me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), në funksion të Procedimit Penal Nr. 182/2020, për veprën penale të “*Korrupsionit pasiv*” dhe “*Shpërdorimi i detyrës*”; janë përdorur metoda speciale të hetimit, të drejtuara nga kjo prokurori – (objektivi B1).

- Janë kryer takime dhe analiza të përbashkëta me Prokurorinë, dhe agjensitë/institucione të tjera ligjzbatuese, 47 takime të reja për këtë periudhë monitorimi dhe 131 në total për deri në këtë periudhë të vitit 2020 - (objektivi B2).
- Janë rritur bashkëpunimet midis Policisë së Shtetit, me “*INTERPOL*” me “*EUROPOL*, *CARIN*, *SELEK*, *BAMIN*, *INTERFORCE*, etj; Forcimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe konferencave të përbashkëta me institucionet homologe ndërkombëtare nëpërmjet seminareve online në të cilët kanë marrë pjesë 12 prokurorë e drejtues të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, 15 prokurorëve dhe OPGJ të Prokurorisë së Posaçme dhe 10 OPGJ të Policisë së Shtetit - (objektivi B4).
- Strategjia e Komunikimit & Vizibilitetit për MD, dhe plani i veprimit 2020 është përfunduar se hartuari dhe publikuar në faqen e MD; Kanë vijuar përgatitjet dhe organizim të fushatave të ndërgjegjësimit dhe afrimin e qytetarëve për të rritur prezencën dhe ndërveprimin me efekte në denoncimin e korrupsionit (fushata e ndërgjegjësimit, Java e Integritetit 2), hartimi i një pakete informimi për masat dhe luftën kundër korrupsionit - (Objektivi C1).

Adresimi i rekomandimeve të dhëna në raportin 6-mujor të monitorimit 2020 (janar - qershor 2020)

Për këtë periudhë monitorimi, *korrik – shtator 2020*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna konkretisht për 105 aktivitete e 60 masa të parashikuara për zbatim, në Planin e Veprimit 2020 – 2023, nga të cilat: 95 aktivitete e 56 masa janë vijuese/në vazhdim nga periudha e mëparshme e vitit dhe 10 aktivitete e 4 masa janë të reja/që kanë filluar zbatimin në këtë tre-mujor të ri dhe mbi të cilat është bërë një vlerësim i ndjekjes së rekomandimeve të dhëna në raportin 6-mujor të monitorimit.

Kështu, rezulton se institucionet vijnë proceset e tyre për kryerjen e aktiviteteve dhe masave për arritjen e vlerave vjetore të performancës sic mund të evidentohen, kryesisht janë aktivitetet dhe masat në objektivat A1, A2, A4, A5, A8, A9, A10, B1, B4, C1; rezulton gjithashtu se aktivitete dhe masa në zbatim të objektivit B1 kanë filluar për së pari zbatimin gjatë kësaj periudhe, *korrik –shtator 2020*.

Mbeten problematike aktivitete dhe masa që për pamundësi financiare të institucioneve zbatuese, për mungesë kapacitetesh njerëzore nuk kanë pasur ecuri dhe zhvillim, duke përfshirë këtu edhe arsyen madhore të Pandemisë Covid-19, përkatësisht në objektivet A7, A11, B2, C3.

Ka vijuar brendësimi i metodologjisë *SIPI/IPSIS* në funksion të raportimit nga institucionet por vijon të mbetet problematike raportimi lidhur me pjesën e buxhetit të përdorur dhe vlerësimin në përqindje të arritjes së qëllimit të politikës.


Krahasuar me periudhën janar - qershor 2020 të monitorimit, gjatë të së cilës ka rezultuar se nga 124 aktivitete dhe 68 masa të monitoruara në Planin e Veprimit 2020 – 2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit janë raportuar: të zbatuara 35 aktivitete e 19 masa prej tyre, 60 aktivitete e 37 masa janë në proces zbatimi, dhe 29 aktivitete e 12 masa janë raportuar të pazbatuara, e duke marrë në konsideratë që për periudhën e re të monitorimit, *korrik – shtator 2020*, janë aktive (për tu zbatuar) 105 aktivitete e 60 masa të monitoruara, ***vihet re se kemi një balancim të numrit të masave në statuset zbatuar - në proces zbatimi - e pazbatuar.***

PROGRESI I ZBATIMIT TË SNKK

Plani i Veprimit 2020 – 2023, për vitin 2020 parashikon zbatimin e 124 aktivitete e 68 masa, të shpërndara përkatësisht në 63 aktivitete e 34 masa për qasjen parandaluese, 37 aktivitete e 25 masa për qasjen ndëshkuese dhe 24 aktivitete e 9 masa për qasjen ndërgjegjësuere.

Për këtë periudhë monitorimi, *korrik - shtator 2020*, rezulton se: 95 aktivitete e 56 masa janë vijuese/në vazhdim nga periudha e mëparshme e vitit, 10 aktivitete e 4 masa janë të reja/që kanë filluar zbatimin në këtë tre-mujor dhe 19 aktivitete e 8 masa janë parashikuar për të filluar zbatimin në tremujorin e katërt të vitit 2020.

Qasja (Qëllimet e Politikës)	Aktivitetet dhe Masat	Aktivitete dhe Masa, korrik – shtator 2020			
		Aktivitete dhe Masa të parashikuara për vitin 2020	Aktivitete dhe Masa në vijim	Aktivitete dhe Masa të reja	Aktivitete dhe Masa për TM4
Parandaluese	Masa	34	30	2	2
	Aktivitete	63	53	4	6
Ndëshkuese	Masa	25	18	1	6
	Aktivitete	37	28	2	7
Ndërgjegjësuere	Masa	9	8	1	0
	Aktivitete	24	14	4	6
Total	Masa	68	56	4	8
	Aktivitete	124	95	10	19




Progresi total i arritur në kuadër të përmbushjes së tre qasjeve të strategjisë lidhur me statusin e zbatimit të aktiviteteve dhe masave është si më poshtë:

- **Aktivite në vijim dhe aktivitete të filluara gjatë periudhës raportuese:**

Nga totali prej 105 aktiviteteve të parashikuara në PV 2020-2020, 57 prej tyre i përkasin Qasjes A, 30 aktivitete i përkasin Qasjes B, si dhe 18 aktivitete Qasjes C.

Statusi i aktiviteteve në Planin e Veprimit 2020 - 2023, për periudhën korrik-shtator 2020				
Progresi i aktiviteteve	Qasja A (Parandaluese)	Qasja B (ndëshkuese)	Qasja C (Ndërgjegjësuere)	Totali i Qasjeve
Zbatuar	19	8	6	33
Në proces	27	5	2	34
Pazbatuar	11	17	10	38
Totali	57	30	18	105

Statuasi i aktiviteteve në periudhën korrik - shtator 2020



Rezultoni se nga 105 aktivitete të parashikuara për periudhën korrik - shtator, aktivitete në vijim dhe të reja, statusi i tyre për të 3 qasjet (për periudhën janar-shtator 2020) është raportuar si më poshtë:


- 33 aktivitete të zbatuara;
- 34 aktivitete janë ende në proces zbatimi;
- 38 aktivitete të pazbatuara nga institucioni përgjegjës,

Aktivitetet sipas të tre statuseve të tyre, të zbatuara, në proces zbatimi dhe të pazbatuara i përkasin të treja qasjeve të Strategjisë.

Masa në vijim dhe masa të filluara gjatë periudhës raportuese:

Nga totali prej 60 masash të parashikuara në PV 2020-2020, 32 prej tyre i përkasin Qasjes A, 19 masa i përkasin Qasjes B, si dhe 9 masa Qasjes C.

Statuasi i masave në Planin e Veprimit 2020 - 2023 për periudhën korrik-shtator 2020				
Progresi i masave	Qasja A (Parandaluese)	Qasja B (Ndëshkuese)	Qasja C (Ndërgjegjëse)	Totali i Qasjeve
Zbatuar	8	9	3	20
Në proces	19	5	1	25
Pazbatuar	5	5	5	15
Totali	32	19	9	60



Rezulton se nga 60 masa të parashikuara për periudhën korrik - shtator, masa në vijim dhe të reja, statusi i tyre për të 3 qasjet (për periudhën janar-shtator 2020) është raportuar si më poshtë:

- 20 masa të zbatuara;
- 25 masa janë ende në proces zbatimi;
- 15 masa të pazbatuara nga institucioni përgjegjës,

Masat sipas të tre statuseve të tyre, të zbatuara, në proces zbatimi dhe të pazbatuara i përkasin të treja qasjeve të Strategjisë.

EKZEKUTIMI I BUXHETIT

Sipas Strategjisë, financimi i Planit të Veprimit realizohet nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe mbështetja financiare e partnerëve ndërkombëtarë.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të aktiviteteve e masave të Planit të Veprimit 2020 - 2023, edhe për këtë periudhë institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi buxhetin e përdorur në bazë të performancës së kryer.

Nga analiza për aktivitetet dhe masat e raportuara në mënyrë progresive, për periudhën *janar – shtator 2020*, buxheti i përdorur rezultoi se:

- Financimi për këtë periudhë monitorimi nga buxheti i shtetit është në shumën 1,383,528,000 lekë.
- Financimi nga donatorët është në shumën 10,668,000 lekë.

Shumë aktivitete të kryera gjatë kësaj periudhe raportimi janë në “kosto administrative”, të mundësuar dhe mbuluara nga kapacitetet njerëzore dhe financiare të institucioneve zbatuese, duke mos paraqitur kosto shtesë për institucionet zbatuese, në përputhje edhe me parashikimin e bërë në Planin e Veprimit. Kështu në total, janë 39 aktivitete që raportohen të jenë kryer me “kosto administrative” dhe 16 aktivitete me 0 (zero) kosto.

Për këtë periudhë monitorimi, *korrik – shtator 2020*, vijon të ketë institucione që nuk kanë pasur mbështetje financiare dhe në këtë mënyrë është ndikuar edhe zbatueshmëria e masave/aktiviteteve, përmendim objektivat A1, A4 dhe C3, i cili vijon në jetë në gjendjen e mospasjes së buxhetit për të zbatuar aktivitetet dhe masat e parashikuara dhe kjo gjendje si pasojë e ndikuar nga Pandemia Covid-19.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer, rezulton se për periudhën *1 korrik – 30 shtator 2020*, fushat që kanë treguar performance por edhe shoqëruar nga problematika janë aktivitete dhe masa të shpërndara në të gjithë objektivet specifike në të tre qasjet e SNKK, parandalim-ndëshkim-ndërgjegjësim.

Institucionet kanë dëshmuar vazhdimësi, përpjekje dhe vullnet për të zbatuar masat, kryer aktivitetet në funksion të tyre, në përputhje me buxhetet e parashikuara në planin e veprimit, mbështetjet e partnerëve ndërkombëtarë dhe vendas; si dhe janë mbështetur në burimet e tyre njerëzore dhe kapacitetet teknike profesionale të brendshme.

Në adresimin e performancës nga institucionet rezulton se mungesa e burimeve njerëzore specifike (kapacitete institucionale dhe pse e parashikuar për tu shtuar në kohën e parashikimit të masave në planin e veprimit); mungesa e buxheteve specifike për kryerjen e veprimtarisë së parashikuar; vonesa në kryerjen e procedurave/fazave të kryerjes së aktiviteteve specifike janë arsye dhe shkaqe që kanë çuar në mosrealizim të objektivave të parashikuar për periudhën e raportimit.

Periudha *korrik – shtator 2020*, përkoi gjithashtu me një situatë të vështirë shoqërore me efekt global Pandemia Covid -19, e cila pati ndikimet e saj të menjëhershme dhe të pakthyeshme edhe në mbarëvajtjen e aktiviteteve institucionale dhe ndërinstitutionale në vend në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2020-2023.

Nga raportimet e ardhura, masa të parashikuara në objektivet specifike A7, B1, B4 e C3 janë të ndikuar drejtpërdrejtë nga pengesa e shkaktuar nga Covid-19.

Rekomandime

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet janë:

- të vijojë kryerja e aktiviteteve dhe masave me synim arritjen e vlerës vjetore të treguesit të performancës, gjë e cila do të afektojë edhe në raportimin e radhës e do të jetë në funksion të raportit vjetor të zbatimit të planit të veprimit 2020-2023,

- të përmirësohet performanca e aktivitetit të institucioneve që raportojnë aktivitete e masa në proces zbatimi,
- të brendësohet metodologjia *SIFI/IPSIS* e raportimit të zbatimit të aktiviteteve e masave për periudhën në zbatim,
- të raportohet informacioni mbi buxhetin e përdorur për masat e planit të veprimit, buxheti i shpenzuar për realizimin e aktiviteteve të mbuluara nga donatorët (informacion i cili nuk disponohet nga të gjitha pikat e kontaktit pranë institucioneve raportuese); buxhetin e shpenzuar për realizimin e aktiviteteve të mbuluara nga buxheti i shtetit e të krijohet një bashkëpunim më i mirë për qëllime raportimi me strukturat/stafet teknike të financës/buxhetit pranë institucioneve raportuese, pasi në kuadër të raportimit kjo është një përgjegjësi e pikave të kontaktit antikorrupsion,
- të raportohet rregullisht në përgjigje të kërkesës së raportimit nga pikat e kontaktit antikorrupsion, sepse mosraportimi ndikon në kryerjen e një analozë reale dhe të saktë të zbatueshmërisë së planit të veprimit.

Aneksi I. Raporti nëntëmujor (i progresit) i monitorimit për Planin e Veprimit 2020-2023

Kodi	Objektivat Strategjike dhe Institucionet Përgjegjëse Respektive	Periudha e zbatimit të Planit të Veprimit			Kosto indikativ e PV	Buxheti i planifikuar për vitin raportues		Buxheti i përdorur	Progresi deri më tani		Problem atikat	Hapat e tjera	Afati i përfundimit
		Fundi i vitit	Vlera e Targetit	/000 total	Totali në %	/000 total	Totali në %	Buxheti i përdorur deri më tani krahasuar me buxhetin indikativ (në %)	Jep me % zbatimin për çdo Qëllim Politike dhe Objektiv Specifik	I zbatuar Zbatuar pjesërisht I pazbatuar	text	text	text
1	Buxheti total për strategjinë			Totali 1+2+3	100								
1	QASJA PARANDALUESE			Totali 1									
A.1	A1. Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion												
	KDIMDHP												
	01110 Planifikim, Menaxhim dhe Administrim												
	KDIMDHP												
A.1.1	Krijimi i sistemit të matjes së transparencës dhe llogaridhënies, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës me qëllim matjen dhe raportimin në mënyrë periodike të nivelit të transparencës				16,464					Zbatuar pjesërisht/në proces			

tek autoritetet publike qendrore dhe të varësisë

	Kosto administrative			<u>Pafilluar (TM IV)</u>	Ky aktivitet është ende hendek financiar dhe ka ndikuar në fillimin e realizimit të saj. Duhet edhe burime njerëzore shtesë.	Në pritje të mundë sive të financimit realizimit e min e aktivitetit	Produkti final është për tu realizuar në 3 mujorin e fundit të vitit 2020
A.1.1.1. 1							
1 (një) Raport vjetor mbi indeksin e Transparencës së Autoriteteve Publik							

KDIMDHP

	4,116	Kosto administrative	80%	<u>Zbatuar pjesërisht/në proces</u>	Ky aktivitet është hendek financiar	Në pritje të mundë sive të financimit realizimit e min e aktivitetit	Dhjetor të cdo viti të PV
A.1.1.2							
Monitorim të transparencës në sasinë e 1/4 të numrit total te autoriteteve publike çdo 3 mujor				Zyra e Komisionerit ka arritur që nëpërmjet burimeve egzistuese të realizojë një pjesë të masës, këtë aktivitet nëpërmjet monitorimit të programeve të transparencës të autoritetet publike qendrore dhe të varësisë me 1/4 për cdo tremujor. Deri në shtator është realizuar ¾ e monitorimeve			

KDIMDHP

A.1.2	Krijimi i sistemit të matjes së transparencës dhe llogaridhënies, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës me qëllim matjen dhe raportimin në mënyrë periodike të nivelit të transparencës tek njësitë e vetqeverisjes vendore	16,464			<u>Zbatuar pjesërisht/në proces</u>				
		Kosto administrative			<u>Pafulluar (TM IV)</u>	Ky aktivitet është ende hendek financiar dhe ka ndikuar në fillimin e realizimit të saj. Duhet edhe burime njerëzore shtesë.	Në pritje të mundësive të financimit për realizimin e aktivitetit	Produkti final është për tu realizuar në 3 muajt e fundit të vitit 2020	
A.1.2.1	1 (një) Raport vjetor mbi indeksin e Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore								
KDIMDHP									
		4,116	Kosto administrative	80%	<u>Zbatuar pjesërisht/në proces</u>	Ky aktivitet është hendek financiar	Në pritje të mundësive të financimit për realizimin e aktivitetit	Dhjetor të cdo viti të PV	
A.1.2.2	Monitorim të transparencës në sasinë e 1/4 të numrit total të autoriteteve publike çdo 3 muaj				Zyra e Komisionerit ka arritur që nëpërmjet burimeve egzistuese të realizojë një pjesë të masës, këtë aktivitet nëpërmjet monitorimit të programeve të transparencës të autoriteteve të njësitë e vetqeverisjes vendore me 1/4 për cdo tremujor. Dëri në përfundim				

të shtator është
realizuar ¼ e
monitorimeve

KDIMDHP

A.1.3 Instalimi i regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve dhe mbikëqyrja e përditësimit të regjistrit nga ana e koordinatorëve për të drejtën e informimit (2020-21 institucione; 2021-24 institucione; 2022-25 institucione; 2023-25 institucione).

16,008

Zbatuar

3,732

2,174

100%

Zbatuar

21 institucione

Për vitet e tjera, i nevojës hëm suporti financiar.

Mbi baza vjetore

A.1.3.1 Numri i institucioneve ku është instaluar regjistri qendror i kërkesave dhe përgjigjeve

Kosto e mirëmbajtjes është mbuluar nga buxheti i Zyrës së Komisionerit.

KDIMDHP

Institucion kontribues: Autoritete publike

Kosto administrative

Kosto administrative

100%

Zbatuar

A.1.3.2 Monitorime të KDIMDHP ndaj koordinatorëve të AP për regjistrin e kërkesë/ankesave

Janë kryer monitorime të rregullta nga Koordinatorëve të Dr.Informimit
Është zbatuar me burimet njerëzore aktuale të Zyrës së Komisionerit

KDIMDHP

Institucion kontribues: Autoritete publike

A2. Rritja e transparencës në planifikimin, detajimin, menaxhimin dhe kontrollin e fondeve buxhetore													
APP													
1087001, Shërbimi i Prokurimit Publik													
APP													
A.2.1	Përmirësimi i procesit të planifikimit nëpërmjet publikimit paraprak të procedurave të prokurimit	8,919								Zbatuar pjesërisht/në proces			
		Kosto administrative	4,566	51%	3.425.5	75%	0%			Zbatuar pjesërisht/në proces	Vonesa në miratimin e kuadrit ligjor që do të ndikojë në miratimin e akteve nënligjore.	Pas miratimit në Kuvend të projekt ligjit, formul arët do të përcakt ohen në akte nënligj ore	2020
A.2.1.1	Hartimi dhe miratimi i formularëve të njoftimit paraprak dhe njoftimit periodik të procedurave të prokurimit									Më datë 29.7.2020 është miratuar në Këshillin e Ministrave projektligji për prokurimin publik.			
APP													
A.2.1.2	Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me përdorimin e njoftimeve paraprake dhe periodike të procedurave të prokurimit (trajnime, vizita studimore, etj)	8,919	0%	0%			0%			Zbatuar pjesërisht/në proces	Proces në vijim për shkak të miratimit të ligjit të ri.	Trajnime et do të zhvillohen në kuadër të implem entimit të ligjit të ri	TM III 2020 e në vijim 2020

APP

A.2.2	Mekanizma për përmirësimin e zbatimit të kontratave	32,811						Zbatuar pjesërisht/në proces			
		Kosto administrative	8,354	25%	6,265.5	75%	0%	Zbatuar pjesërisht/në proces	Vonesa në miratimin e kuadrit ligjor që do të mundësojë miratimin e akteve nënligjore.	Pas miratimit në Kuvend të projekt ligjit, formulari do të përcakt ohen në akte nënligjore.	2020
A.2.2.1	Hartimi dhe miratimi i instrumentave të nevojshëm për monitorimin e zbatimit të kontratës (Plani i zbatimit të kontratës; formulari i zbatimit të kontratës)							Më datë 29.7.2020 është miratuar në Këshillin e Ministrave projektligji për prokurimin publik.			

APP

A.2.2.2	Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me monitorimin e zbatimit të kontratës (trajnime, vizita studimore, etj).	32,811	0%	0%			100%	Zbatuar		Trajnime dhe do të zhvillohen në kuadër të implem entimit të ligjit të ri.	Dhjetor 2023
								Janë zhvilluar ëbinares 2 persona të trajnuar Trajnimet kryesisht zhvillohen nga institucione të tjera (vendase dhe nderkombëtare) ndaj nuk paraqesin kosto të shtuar për APP.			

APP

A.2.3	Mekanizma për përmirësimin e dokumentave të tenderit dhe specifikimeve teknike	46,127						<u>Zbatuar</u>		
		Kosto administrative	13,516	29%	10,137	75%	100%	<u>Zbatuar</u>	Për shkak të rolit proakti v që APP ka në fushën e prokurimit publik, ajo nxjerr rekomandime për Autoritetet Kontraktoren të gjetjeve.	Dhjetor 2023
A.2.3.1	Hartimi dhe publikimi i rekomandimeve të vazhdueshme nga APP në lidhje me përmbajtjen e dokumentave të tenderit të përgatitura nga autoritetet/entet kontraktore me qëllim përmirësimin e tyre (Nr. i rekomandimeve të nxjerra)							1 rekomandim i ri (total 4 Rekomandime të nxjerra për periudhën e vitit 2020)		
APP										
A.2.3.2	Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me përgatitjen e dokumentave të tenderit, në përputhje me parimet e transparencës, mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë, konkurrencës së lirë dhe të ndershme (trajnime, vizita studimore, etj)	46,127	0%	0%			100%	<u>Zbatuar</u>	Trajnimet do të zhvillohen në kuadër të implemtimit të ligjit të ri.	Dhjetor 2023
								Janë zhvilluar ëebinar-e 2 persona të trajnuar Trajnimet kryesisht janë zhvilluar nga institucione të tjera (vendase dhe nderkombëtare) ndaj nuk paraqesin kosto të shtuar për APP.		

APP

A.3 **A. 3: Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike**

AKSHI

01140, e-Qeverisja

AKSHI

A.3.1 Numri i shërbimeve elektronike funksionale për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike

214,400

Zbatuar

kosto
administrat
ive

Kosto administrative

95%

Zbatuar

Mbi baza
vjetore

A.3.1.1
1 Nr. shërbimesh elektronike të shtuara; (2020-602 shërbime; 2021-670 shërbime; 2022-720 shërbime e 2023-750 shërbime)

Nga janari i vitit 2020, ka filluar një proces i ri për shërbimet publike, ai i ofrimit të aplikimeve për shërbime publike për qytetarët dhe bizneset vetëm online. Qytetarët dhe bizneset aplikojnë vetëm përmes platformës e-Albania dhe janë punonjësit e administratës publike ata që mbledhin të gjitha dokumentet shtetërore të shërbimeve. Të gjitha të dhënat dhe dokumentet shtetërore tani përdoren dhe ripërdoren, duke i çliruar qytetarët nga barra e

grumbullimit të tyre fizikisht në letër në sportelet e shtetit.

Total 620

shërbime

Shërbime online

janë në:**ASHK**

(Rivlerësimi i

pasurisë);

MD(Aplikim për

ekspert

gjykatë;Vlerësim i

ekspertëve në

gjykata;Vërtetim si

ekspert gjykatë);

MASR (Aplikim për

Fondin e

Ekselencës(për

nëpunësit e

administratës

shtetërore/për

studentët e ciklit

të parë dhe të

dytë/për studimet

e doktoraturës);

Aplikim për

vërtetim për

gradat shkencore

dhe titujt

akademikë);

MTM(Aplikim për

vlerësimin e

